



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 2, datë 28.01.2026

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 5, DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME TIRANË SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.01.2026 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.".

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë me shkresën nr. 1069 prot. datë 21.01.2026 me lëndë: "Njoftim mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe një nga drejtuesi teknik të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor dhe një nga drejtuesit teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar. Me postë elektronike datë 21.01.2026 dhe 23.01.2026 ka bërë plotësimet përkatëse.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.

3. KKRR ka licencuar Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me vendimin nr. 5, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a,” me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.
4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a z. Flauers Shoshi është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknik në vitin 2005.
5. Drejtues teknik i shoqërisë z. Erald Bali me titull Inxhinier Elektrik është diplomuar Universiteti Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dega Elektrike në vitin 2011 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
6. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.a, të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 a) dhe 2 b) e vendimit të KKRR nr. 5, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a’ ndryshojnë si më poshtë:
 - a) Drejtues Ligjor z. Flauers Shoshi
 - b) Drejtues Teknik z. Erald Bali

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gerta Lubonja